Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut

Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

MENDIM

Data e miratimit: 18 mars 2011

Lënda nr. 05/07

Sllavko VULIQ

kundër

UNMIK-ut

Paneli këshillëdhënës për të drejta të njeriut, në seancën e mbajtur më 18 mars 2011, në praninë e anëtarëve vijues:

z. Paul LEMMENS, kryesues
znj. Christine CHINKIN

Të ndihmuar nga
znj. Anila PREMTI, ushtruese e detyrës së zyrtares ekzekutive

Pasi konstatoi tërheqjen e z. Marek NOWICKI nga shqyrtimi i kësaj lënde në përputhje me rregullën 12 të Rregullores së punës,

Pasi shqyrtoi ankesën e lartpërmendur, të parashtruar në përputhje me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 për themelimin e Panelit këshillëdhënës për të drejta të njeriut, të datës 23 mars 2006,

Pas diskutimit, vendosi si në vijim:

I. Procedurat para Panelit

1. Ankesa është parashtruar më 15 shtator 2007 dhe është regjistruar më 18 tetor 2007. Në fillimin e procedurave para Panelit këshillëdhënës për të drejta të njeriut (Paneli), ankuesi

është përfaqësuar nga Praxis, organizatë kjo joqeveritare me qendër në Beograd, Serbi. Më vonë ankuesi vendosi që vet të përfaqësohet para Panelit.

2. Paneli ia komunikoi rastin Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) më 7 shkurt 2008, duke ia dhënë atij mundësinë që të jep komentet në emër të UNMIK-ut lidhur me pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e lëndës, në pajtim me rregullën 30 të Rregullores së punës të Panelit. PSSP-ja nuk ka shfrytëzuar këtë mundësi.

3. Më 7 maj 2008 Paneli shpalli ankesën si të pranueshme.

4. Më 9 maj 2008 Paneli ia komunikoi lëndën PSSP-së në pajtim me nenin 11.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 për themelimin e Panelit këshillëdhënës për të drejta të njeriut, të datës 23 mars 2006, me qëllim të marrjes së përgjigjes së UNMIK-ut lidhur me bazueshmërinë e lëndës.

5. Më 16 shtator 2008, PSSP-ja u përgjigj, duke bashkëngjitur letrën e datës 4 shtator 2008 të dërguar nga AKP-ja, dhe ftoi Panelin të kërkojë informatë drejtpërdrejtë nga organizata pasuese e HPD-së – AKP-ja. Më 25 shtator dhe 6 tetor 2008, Paneli ia përcolli ankuesit komentet e PSSP-së në mënyrë që të merrte përgjigjen e tij.

6. Më 15 tetor 2008, ankuesi u përgjigj me komentet e tij dhe me informata shtesë.

7. Më 29 tetor 2008, Paneli kërkoi kopjet e dosjeve të AKP-së përkitazi me kërkesëpadinë e ankuesit. Më 17 nëntor 2008, AKP-ja dha dosjen e plotë të lëndës.

8. Më 17 dhjetor 2008, Paneli kërkoi informata shtesë nga AKP-ja. AKP-ja u përgjigj më 14 janar 2009, duke theksuar që, si përjashtim, do të kishte pasur dëshirë të ndihmonte ankuesin për të zgjidhur rastin e tij.

9. Më 23 janar 2009, Paneli ia përcolli letrën e AKP-së ankuesit. Më 12 shkurt 2009 ankuesi u përgjigj.

10. Më 18 maj 2009 dhe 11 qershor 2009, ankuesi i dha Panelit informata shtesë.

11. Më 17 qershor 2009, Paneli është vënë në dijeni se ankuesi dhe AKP-ja kishin arritur një marrëveshje lidhur me përmbarimin e vendimit në rastin e ankuesit. Më pastaj, vendimi është përmbaruar më 24 qershor 2009.

12. Pas përmbarimit të vendimit, Paneli pyeti ankuesin nëse dëshironte të vazhdonte lëndën e tij para Panelit. Ankuesi bëri me dije se dëshironte të vazhdonte procedurat rreth ankesës së tij.

II. FAKTET

A. Faktet para vendimit të Panelit për pranueshmëri

13. Ankuesi ka qenë banor i Kosovës që asokohe jetonte si person i zhvendosur në Serbi.

14. Para fillimit të armiqësive, ankuesi ka jetuar me familjen e tij në fshatin Rudicë, komuna e Klinës, në shtëpinë e babait të tij të ndjerë. Në të njëjtën ngastër ishte edhe shtëpia e dytë që gjithashtu i përkiste familjes. Ankuesi doli nga Kosova në vitin 1999. Pas shkuarjes së ankuesit, shtëpia e parë është zënë nga një person i tretë dhe familja e tij. Shtëpia e dytë është dëmtuar dhe nuk ka mundur të banohet. Siç do të shpjegohet më poshtë, fakti se të dy shtëpitë gjendeshin në të njëjtën ngastër, me të njëjtin numër kadastral, ishte burim hutie për autoritetet që merren me kërkesën pronësore të ankuesit për riposedim të pronës së tij.

15. Më 2 maj 2002, ankuesi paraqiti kërkesë pronësore para Drejtorisë Pronësore Banesore (HPD), duke kërkuar riposedimin e pronës së tij. Kërkesa pronësore kishte të bënte me shtëpinë e parë, të cekur më lartë (§ 14), por ankuesi gjithashtu përmendi ekzistimin e shtëpisë së dytë.

16. Komisioni për Kërkesa Pronësore-Banesore (HPCC) i HPD-së më 29 prill 2005 lëshoi vendim, përmes së cilit aprovohej kërkesa pronësore dhe përcaktohej se ankuesi ishte pronar i pakontestueshëm i pronës para datës 24 mars 1999. Megjithatë, në vendim po ashtu thuhej se "prona e banimit, për të cilën është parashtruar kërkesa pronësore, është shkatërruar pasi që kërkuesi humbi posedimin e pronës dhe se ngastra e tokës nuk ishte e zbrazët".

17 Më 7 korrik 2005, ankuesi parashtroi kërkesë për rishqyrtim të vendimit të datës 29 prill 2005. Ai theksoi se ka vizituar pronën në vitin 1999, 2003 dhe 2005 dhe se kishte vërejtur shtëpia e cekur në kërkesën pronësore ishte e paprekur dhe ishte e zënë nga një familje tjetër që nga viti 1999. Nga ana tjetër, shtëpia e dytë në të njëjtën ngastër ishte djegur, mirëpo muret dhe tavani i asaj shtëpie ishin ruajtur, kështu që familja që jetonte në shtëpinë e parë shfrytëzonte shtëpinë e dytë për bagëti. Në bazë të ankuesit, HPCC-ja ka bazuar vendimin e tij në gabim material.

18. HPCC-ja miratoi kërkesën për rishqyrtim përmes vendimit të datës 16 nëntor 2006. HPCC-ja pranoi se prona e kërkuar nuk ishte shkatërruar dhe se në fakt ishte uzurpuar nga pala tjetër. HPCC-ja gjithashtu theksoi se uzurpuesi i shtëpisë nuk ka fituar ndonjë të drejtë ndaj pronës, por vetëm ka theksuar se ai dhe familja e tij nuk kishin vend tjetër për të jetuar.

19. Më 10 janar 2007 ankuesi dhe uzurpuesi janë njoftuar për vendimin për rishqyrtim.

20. Më 11 janar 2007, ankuesi parashtroi kërkesë për riposedim.

21. Më 20 shkurt 2007, regjistruesi i Agjencisë Kosovare të Pronave (AKP), e cila ka trashëguar HPD-në, lëshoi urdhrin për dëbim.

22. AKP-ja u përpoq të realizojë largimin nga prona më 28 shkurt 2007. Mirëpo, fqinjët i thanë zyrtarit të AKP-së se ai po bënte largimin në pronën që i përket personit tjetër, dhe zyrtari është drejtuar në shtëpinë e shkatërruar. Zyrtari kërkoi nga AKP-ja të kontaktojë ankuesin dhe ta pyes për gjendjen pronësore të të dy shtëpive, por një kontakt i tillë nuk ka mundur të bëhet. Zyrtari kishte plumbuar shtëpinë e shkatërruar. Më 1 mars 2007, një ditë para se ankuesi është dashur të merr çelësat nga AKP-ja, ai erdhi nga Beogradi për të vizituar pronën e tij, ku erdhi në përfundim se e njëjta ende ishte e uzurpuar. Për atë arsye, ai nuk morri çelësat, por iu ankua AKP-së për faktin se largimi nuk ishte bërë.

23. Më pastaj është caktuar dëbimi i dytë për datën 19 prill 2007. AKP-ja kontaktoi ankuesin më 10 mars 2007 për ta informuar atë lidhur me datën e dëbimit. Ankuesi do të mund t'i merrte çelësat e pronës më 20 prill 2007. Në bazë të AKP-së, kjo Agjenci ka informuar ankuesin se prona do të konsiderohet si e marrë në riposedim që nga data 20 prill 2007, pavarësisht nëse ankuesi i merr çelësat apo jo. AKP-ja gjithashtu ka deklaruar se ankuesi ka qenë i informuar se AKP-ja nuk do ta riekzekutoj 72 orë pas dëbimit fillestar në rast se prona uzurpohet përsëri. Pas kësaj date policia do të jetë përgjegjëse për dëbim. AKP-ja thekson se dëbimi i dytë është kryer me sukses sipas datës së paraparë, ku janë ndërruar bravat dhe prona është plumbuar. Çelësat më pastaj janë lënë në Zyrën rajonale të AKP-së në Pejë sipas marrëveshjes. Megjithatë, ankuesi nuk ka marrë çelësat. Përsëri, ankuesi deklaroi se ditën kur ka qenë e paraparë të merrte çelësat nga AKP-ja, ai vizitoi pronën dhe erdhi në përfundim se e njëjta ende ishte e uzurpuar.

24. Më 23 prill 2007, ankuesi informoi AKP-në se prona ishte ende e uzurpuar. 'Përjashtimisht', AKP-ja u pajtua për të realizuar edhe një largim 'në bazë të asaj se ankuesi nuk ka qenë në gjendje të sigurojë ndihmesë të policisë për marrjen në riposedim të pronës së tij'. Largimi i tretë ka qenë i paraparë për 19 qershor 2007. Më 25 maj 2007, AKP-ja informoi ankuesin se çelësat do të ishin të gatshëm për t'i marrë më 20 qershor 2007. AKP-ja thotë se dëbimi i tretë është realizuar me sukses sipas datës së paraparë, me ç'rast janë ndryshuar bravat dhe prona është plumbosur. Më pastaj, çelësat janë lënë në Zyrën rajonale të AKP-së në Pejë sipas marrëveshjes. Përsëri, ankuesi deklaroi se ditën kur ka qenë e paraparë të merrte çelësat nga AKP-ja, ai vizitoi pronën dhe erdhi në përfundim se e njëjta ende ishte e uzurpuar.

25. Më 9 gusht 2007, OJQ-ja Praxis i dërgoi letër AKP-së në emër të ankuesit, duke e informuar atë se prona ishte ende e zënë nga uzurpatori dhe duke kërkuar kryerjen e largimit. Në dosje nuk ekziston ndonjë përgjigje e AKP-së në këtë komunikim.

26. Më 28 nëntor 2007, OJQ-ja Praxis prapë kishte kontaktuar AKP-në në emër të ankuesit, duke e informuar atë se i njëjti uzurpator vazhdonte të banonte në pronë, duke kërkuar nga AKP-ja që ta merr pronën në riposedim. AKP-ja informoi Praxis-in se autoriteti i saj për këtë çështje ka përfunduar dhe se tani e njëjta do të duhej të trajtohej nga agjencitë e rendit dhe ligjit.

27. Më 12 shkurt 2008, Praxis prapë kontaktoi AKP-në, duke kërkuar ndihmesë për lëndën e ankuesit. Më 3 mars 2008, AKP-ja u pajtua ta marrë pronën në riposedim pasi që ankuesi nuk ka mundur të sigurojë ndihmesën e policisë. Ankuesi më pastaj ka kërkuar që të jetë i

pranishëm me rastin e dëbimit. AKP-ja refuzoi këtë kërkesë në bazë të asaj se për shkaqe të sigurisë procedurat e saj standarde të punës ndalonin praninë e titullarëve të së drejtës në pronë gjatë procesit të largimit. Megjithatë, AKP-ja deklaroi se ankuesi do të mund të merrte çelësat në stacionin lokal të policisë në të njëjtën ditë. Ankuesi nuk u pajtua me këtë procedurë dhe, si rrjedhojë, dëbimi nuk është kryer. AKP-ja më pastaj ka sugjeruar që ankuesi ta kontakton policinë për ta kryer dëbimin apo, si zgjidhje tjetër, të pajtohet me procedurat e AKP-së.

B. Faktet pas vendimit të Panelit për pranueshmëri

28. Ankuesi thotë se në fund të qershorit 2008 ai kishte kontaktuar policinë në Klinë për t'i ndihmuar në lirimin e pronës nga uzurpuesi. Mirëpo, policia i kishte thënë se do të duhej t'i drejtohet AKP-së, pasi AKP-ja ishte autoriteti kompetent për këtë çështje dhe se 'policia mund të reagojë vetëm në rast se prona riuzurpohet'.

29. Në gusht të vitit 2008, ankuesi kishte vizituar pronën përmes vizitës "shko e shih", të organizuar nga OJQ-ja e quajtur Këshilli Danez për Refugjatë. Gjatë vizitës, ankuesi prapë kishte parë duke punuar në kopsht familjen që kishte uzurpuar shtëpinë e tij. Ai thotë se gjatë vizitës atij i ishte lejuar që vetëm të shihte shtëpinë e djegur në pronën e tij e jo edhe shtëpinë e banuar.

30. Në letrën e datës 15 tetor 2008 drejtuar Panelit, ankuesi kërkoi që Paneli ta urdhëronte AKP-në të "lëshojë konfirmim me shkrim për lirimin e realizuar të pronës pas marrjes së çelësave, ashtu që të mund t'i drejtohem policisë në rast të riuzurpimit të pronës sime".

31. Më 17 dhjetor 2008, Paneli ia përcolli letrën e ankuesit AKP-së me qëllim të marrjes së përgjigjes nga e njëjta. Më 14 janar 2009, Paneli morri përgjigjen, ku AKP-ja ritheksoi gatishmërinë e saj që përjashtimisht t'i ndihmojë ankuesit, përderisa ankuesi të pajtohej me procedurat standarde të punës për lirimin e tillë të pronës.

32. Ankuesi iu përgjigj Panelit më 12 shkurt 2009, duke shprehur gatishmërinë për të mos qenë i pranishëm gjatë lirimit, nëse përfaqësuesit e Panelit dhe të AKP-së do të ishin të pranishëm gjatë lirimit të pronës dhe që AKP-ja t'ia dorëzonte çelësat ankuesit në prani të përfaqësuesve të Panelit menjëherë pas lirimit të shtëpisë dhe mu para saj. Paneli ia përcolli përgjigjen ankuesit, ku theksoi se nuk do të jetë në gjendje ta plotësojë kërkesën e ankuesit sa i përket pranisë së përfaqësuesit të tij, pasi që një rol i tillë ishte jashtë mandatit të Panelit.

33. Ankuesi thotë se gjatë shkurtit 2009 ai ka marrë pjesë në mbledhjen e Grupit punues komunal për komunën e Klinës, ku kanë qenë të pranishëm përfaqësuesit e komunës, Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) dhe shoqata Glas Kosova (Zëri i Kosovës). Gjatë mbledhjes është arritur pajtimi që uzurpuesi do të lejohet të rrijë në shtëpinë e ankuesit derisa ky i fundit të kthehej në fshatin Rudicë. Pas arritjes së grupit të parë të të kthyerve, komuna do të largonte familjen uzurpuese nga shtëpia. Ankuesi po ashtu thekson se ishte arritur pajtimi që ai të ishte pjesë e grupit të parë të të kthyerve. Kështu, ai do të mund të hyjë në shtëpinë e tij, së bashku me të

kthyerit e tjerë. Këta të fundit do të qëndronin përkohësisht, në pritje të rindërtimit të shtëpive të tyre.

34. Gjatë mbledhjes së 29 prillit të Grupit punues komunal, ku kanë marrë pjesë përfaqësuesit e komunës, Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), UNHCR-së, Këshillit Danez për Refugjatë, KFOR-it, Ministrisë për Komunitete dhe Kthime të Kosovës dhe të shoqatës së personave të zhvendosur brenda vendit – Bozhur, bashkërenduesi i projektit i UNDP-së supozohet se ka sugjeruar se ankuesi i ka dhënë familjes uzurpuese 5 arë tokë sepse ata kanë qenë rast social. Kështu, shtëpia do të mund të ndërtohej për atë familje dhe çështja e tyre e banimit do të zgjidhej. Më pastaj UNDP-ja dhe komuna do ta rinovonin së bashku shtëpinë e djergur të ankuesit. Ankuesi deklaron se bashkërenduesi i komunës dhe përfaqësuesi i UNDP-së kanë vazhduar t'i bëjnë presion për të pranuar ofertën pas përfundimit të mbledhjes. Ankuesi refuzoi ofertën, duke theksuar se dëshironte që uzurpuesi të largohej. Supozohet se ankuesit i është thënë që, përveç nëse ai ishte në gjendje të siguronte largimin e uzurpuesit dhe familjes së tij, ai do ta përjashtohej nga projekti i kthimit.

35. Më 7 maj 2009, grupi i parë i të kthyerve u kthye në fshatin Rudicë. Ankuesi nuk ishte në mesin e tyre. Në ditën e njëjtë OJQ-ja Praxis i dërgoi letër UNHCR-së dhe OSBE-së, duke kërkuar që përfaqësuesit e çdo organizate të jenë të pranishëm gjatë largimit të uzurpuesve nga AKP-ja, për t'u siguruar që i njëjti ka ndodhur. Vetëm në rast se OSBE-ja dhe UNHCR-ja do të pajtoheshin, atëherë ankuesi do të kontaktonte AKP-në për të caktuar terminin e largimit. Mirëpo, UNHCR-ja nuk pranoi të jetë e pranishme në largim, ndërsa OSBE-ja nuk i është përgjigjur letrës.

36. Më 11 qershor 2009, ankuesi prapë kontaktoi AKP-në, duke dhënë një pasqyrë të përgjithshme të rrethanave deri në atë moment, dhe duke kërkuar që AKP-ja t'ia mundësonte të jetë i pranishëm gjatë largimit apo, si mundësi tjetër, që AKP-ja të lëshonte një vërtetim pas largimit, përmes të cilit do të vërtetohej se është kryer largimi dhe se prona është plumbosur.

37. Pas një bisede telefonike mes ankuesit dhe AKP-së më datë 15 qershor 2009 dhe pas letrës së dërguar nga AKP-ja më 16 qershor 2009, ankuesi dhe AKP-ja u pajtuan më 17 qershor 2009 për rrjedhën e dakorduar të veprimeve lidhur me largimin. Largimi do të bëhej më 24 qershor 2009, ku do të merrnin pjesë udhëheqësi i Njësisë për zbatim të AKP-së, i shoqëruar nga përfaqësuesi i Praxis. Ankuesi do të shikonte largimin nga shtëpia tjetër që në atë kohë po rindërtohej. Pas largimit, udhëheqësi i Njësisë për zbatim, udhëheqësi i Njësisë për largim dhe përfaqësuesi i Praxis do të takoheshin me ankuesin në atë shtëpi me qëllim të nënshkrimit të dokumentacionit dhe pranim-dorëzimit të çelësave.

III ANKESA

39. Ankuesi ankohet se kohëzgjatja e procedurave në rastin e tij, duke përfshirë zbatimin e vendimit të HPCC-së, nuk ka qenë në përputhje me të drejtën për vendim brenda një kohe

të arsyeshme, e cila garantohet përmes nenit 6 § 1 të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (KEDNj).

40. Ankuesi më tej ankohet për faktin se në datën e parashtrimit të ankesës, moszbatimi i vendimit ka shpërfillur të drejtën në pronësi, gjë kjo që *de fakto* ka qenë e barabartë me shpronësim. Në këtë aspekt, ai thirret në shkeljen e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së

41. Ankuesi gjithashtu thotë se në atë kohë ai është parandaluar të ketë qasje dhe të marrë në riposedim pronën e tij dhe të gëzojë lirshëm hapësirën tij private. Në bazë të tij, UNMIK-u nuk ka mbrojtur të drejtën e tij për respekt ndaj shtëpisë dhe ndaj jetës private, ku AKP-ja ka ndërhyrë në këtë të drejtë pa justifikimin e duhur. Në këtë aspekt ai thirret në shkeljen e nenit 8 të KEDNj-së.

42. Ankuesi në fund argumenton se pamundësia e lartpërmendur për zbatimin e vendimit në të mirën e tij ndikon në "efektshmërinë" e mekanizmit të HPD/HPCC-së si mjet ligjor në kontestet pronësore-banesore. Nuk ka në dispozicion ndonjë mjet tjetër ligjor. Në këtë drejtim, ai thirret në shkeljen e nenit 13 të KEDNJ-së

IV. LIGJI

A. Shkelja e pretenduar e nenit 6 § 1 të KEDNj-së

1. Zbatueshmëria e nenit 6 § 1 të KEDNJ-së

43. Si çështje bazë, Paneli duhet të përcaktojë nëse zbatohet neni 6 § 1 në këtë rast. Në pjesën relevante ti tij, neni 6 § 1 thotë:

> Në përcaktimin e të drejtave dhe obligimeve të tij civile apo të çfarëdo padie penale kundër tij, çdokush ka të drejtë në seancë dëgjimore të drejtë dhe publike brenda kohës së caktuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar sipas ligjit [...].

44. Neni 6 § 1 i KEDNj-së vlen për përcaktimin e "të drejtave dhe obligimeve qytetare". Paneli thekson se procedurat para HPCC-së lidhur me të drejtat e ankuesit lidhur me ndonjë pronë të caktuar banesore /vërejtje e përkthyesit: fjalia e papërfunduar/. Rrjedhimisht, procedurat kanë qenë të ndërlidhura me përcaktimin e të drejtës pronësore të ankuesit, e drejtë kjo që qartazi është e natyrës "civile" (shih Gjykata Evropiane për të drejta të Njeriut (GjEDNj) *Zander kudër Suedisë,* aktgjykimi i datës 25 nëntor 1993, Botime to Gjykatës, Seria A, nr. 279-B, f. 40, § 27).

45. Në parim, neni 6 §1 i KEDNJ-së vlen vetëm për procedurat para një 'gjykate'. GjEDNj-ja ka deklaruar se gjykata "karakterizohet në kuptimin thelbësor të fjalës nga funksioni i saj gjyqësor, gjegjësisht ka të bëjë me përcaktimin e çështjeve brenda kompetencave të saj në

bazë të rregullave ligjore dhe pas procedurave të zbatuara sipas mënyrës së paraparë" (GjEDNj (Dhoma e lartë), *Qipro kundër Turqisë*, nr. 25781/09, aktgjykimi i datës 10 maj 2001, GjEDNj, 2001-VI, § 233). Përveç kësaj, gjykata në fjalë duhet të ketë juridiksion për shqyrtimin e të gjitha çështjeve faktike dhe ligjore që janë relevante për kontestin para saj (shih GjEDNj, *Ollujiq kundër Kroacisë*, nr. 22330/05, aktgjykimi i datës 5 shkurt 2009, § 38). Megjithatë, në mënyrë që një organ të kualifikohet si "tribunal", neni 6 § 1 i GjEDNj-së nuk parasheh që gjykata të jetë "një gjykatë klasike, e integruar në sistemin standard gjyqësor të vendit" (GjEDNj, *Kempell dhe Fell kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aktgjykimi i datës 28 qershor 1984, *Publikimet e Gjykatës*, Seria A, nr. 80, f. 39, § 76).

46. Në kuadër të këtij konteksti, Paneli cek se HPCC-ja nuk ka qenë gjykatë e tipit klasik, por ka qenë një organ i trajtimit të një numri të madh të kërkesave pronësore, i cili ka lëshuar vendime obliguese dhe të zbatueshme (shih Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/23, e datës 15 nëntor 1999, për themelimin e Drejtorisë pronësore-banesore dhe të Komisionit për kërkesa pronësore-banesore). Rregullorja e punës për procedurat para HPCC-së është përcaktuar përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/60, të datës 31 tetor 2000 për kërkesat lidhur me pronat banesore dhe për rregulloren e punës dhe të dëshmive të Drejtorisë pronësore-banesore dhe të Komisionit për kërkesa pronësore-banesore, ku HPCC-ja ka marrë vendime për kërkesa pronësore në bazë të rregullave ligjore dhe në kuadër të një procesi me palë të paditura dhe paditës. Këto vendime kanë qenë të formës së prerë dhe janë zbatuar nga organi administrativ, gjegjësisht nga HPD-ja, e më vonë nga AKP-ja. Kështu, funksioni i HPCC-së ka qenë gjyqësor dhe neni 6 i KEDNJ-së vlen për procedurat para HPCC-së (shih Paneli Këshillëdhënës për të Drejta të Njeriut (PKDNj, *Vuçkoviq* nr. 03/07, mendimi i datës 13 mars 2010, § 34).

2. Përputhshmëria me nenin 6 § 1 të KEDNj-së

a. Argumentet e palëve

47. Ankuesi thotë se përmbarimi i aktgjykimit të formës së prerë dhe obligues është pjesë përbërëse e garancive për gjykim të drejtë, pasi që vetëm kur zbatohet një vendim i tillë, të drejtat bëhen të efektshme, Një zgjatje e paarsyeshme e zbatimit të vendimit gjyqësor rezulton me shkeljen e nenit 6 § 1 të KEDNJ-së. Pas parashtrimit të kërkesës së tij në maj të vitit 2002 dhe pas marrjes së vendimit të formës së prerë lidhur me të në nëntor të vitit 2006, procedurat për zbatimin e vendimit të formës së prerë ende nuk ishin përfunduar kur ankuesi parashtroi ankesën e tij në Panel, më 15 shtator 2007. Ai deklaron se lënda nuk ka qenë shumë e ndërlikuar dhe sjellja e 'palëve' nuk ka kontribouar në vonesën e procedurave. Për më tepër, ankuesit i është shkaktuar dëm i caktuar material pasi që ka jetuar si person i zhvendosur gjatë procedurave para HPCC-së dhe derisa ka pritur për zbatimin e vendimit. Ai më tej shton se autoritetet nuk e kanë parë të udhës t'i respektojnë rregullat e largimit të personave nga pronat e uzurpuara, dhe nuk kanë marrë parasysh gjendjen e vështirë materiale të ankuesit si nxitje për përfundimin e shpejtë të rastit, gjegjësisht për largimin e uzurpuesit dhe marrjen në riposedim të shtëpisë nga ankuesi brenda një kohe të arsyeshme. Për këto arsye ankuesi deklaron se kohëzgjatja e procedurave nuk ka qenë në përputhje me afatet e arsyeshme kohore.

48. Në komentet e tij të datës 16 shtator 2008, PSSP-ja thotë se AKP-ja ka bërë dy largime të suksesshme dhe se mosmarrja e çelësave të pronës nga ankuesi në kohën dhe vendin e pajtuar ka qenë arsyeja e uzurpimit të vazhdueshëm të pronës së tij. Më tej, PSSP-ja vë re se përderisa ankuesi ka mundur t'i drejtohet policisë lidhur me uzurpimin e pronës së tij, AKP-ja ka shprehur gatishmërinë që përjashtimisht të bënte edhe një largim, por vetëm në përputhje me procedurat e saj standarde të punës.

b. Vlerësimi i Panelit

49. Ankuesi ankohet për kohëzgjatjen e procesit të përmbarimit të vendimit të HPCC-së, të datës 16 nëntor 2006. Ai thotë se "zhagitja e paarsyeshme" e këtij procesi ka rezultuar në shkeljen e kushtit për kohë të arsyeshme, të paraparë në nenin 6 § 1 të KEDNj-së.

50. Paneli i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut lidhur me përmbarimin e vendimeve gjyqësore. Gjykata vazhdimisht konstaton se neni 6 § 1 i KEDNJ-së ia garanton secilit të drejtën për të parashtruar kërkesëpadi lidhur me të drejtat dhe obligimet e tij qytetare, të përcaktuara nga gjykata apo tribunali. Kjo e drejtë do të ishte imagjinare nëse sistemi ligjor i shtetit do të lejonte që vendimi gjyqësor i formës së prerë dhe obligues të mos jetë funksional dhe të jetë në dëm të njërës palë. Në bazë të Gjykatës, do të ishte e papërfytyrueshme që neni 6 § 1 të përshkruajë në hollësi garancat procedurale që u jepen palëve në kontest – procedura që janë të drejta, publike dhe të shpejta – pa mbrojtjen e vendimeve gjyqësore. Përmbarimi i aktgjykimit të nxjerrë nga cilado gjykatë, rrjedhimisht konsiderohet si pjesë përbërëse e "gjykimit" për qëllime të nenit 6. Një vonesë e paarsyeshme në përmbarimin e aktgjykimit obligues mund ta shkel KEDNj-në. Arsyeshmëria e një vonese të tillë duhet të përcaktohet, duke pasur parasysh ndërlikueshmërinë e procedurave të përmbarimit, sjelljen e palës ankuese dhe sjelljen e autoriteteve kompetente, si dhe natyrën e vendimit të gjykatës. Një vonesë e caktuar në përmbarimin e aktgjykimit mund të arsyetohet në rrethana të veçanta, por një asnjë rast, kjo vonesë nuk mund të jetë e tillë që ta rrezikojë thelbin e së drejtës, të mbrojtur sipas nenit 6 § 1 (shih në mesin e aktgjykimeve të tjera, GjEDNj, *Hornsbi kundër Greqisë*, aktgjykimi i datës 19 mars 1997, *Raportet*, 1997-II, f.510, § 40; GjEDNj, *Marini kundër Shqipërisë* nr. 3738/02, Aktgjykimi i datës 18 dhjetor 2007, § 126; GjEDNj, *Burdov kundër Rusisë* (nr. 2), nr. 33509/04, aktgjykimi i datës 15 janar 2009, §§ 66-67).

51. Derisa ankuesi në mënyrë specifike thirret në të drejtën për vendim brenda një kohe të arsyeshme, duke patur parasysh praktikën e lartpërmendur ligjore të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut, Paneli konsideron se do të ishte më e duhur që ankesa të shqyrtohet nga pikëpamja e së drejtës një gjykatë, posaçërisht e së drejtës për përmbarimit të vendimit të formës së prerë dhe obligues.

52. Paneli thekson se HPCC-ja ka miratuar vendimin e tij për rishqyrtim më 16 nëntor 2006. Ai vendim është zbatuar më 24 qershor 2009, kur AKP-ja kishte larguar me sukses uzurpuesin e paligjshëm. Kështu, janë dashur më shumë se katër vite e shtatë muaj para se vendimi të përmbarohej në mënyrë të suksesshme.

53. Megjithatë, Paneli po ashtu nënvizon se juridiksioni i tij është i kufizuar përkitazi me pretendimet për shkeljet e bëra nga UNMIK-u. Pra, nuk mund të shqyrtojë ankesa lidhur me faktet apo lëshimet që janë bërë në momentin kur UNMIK-u nuk ishte më përgjegjës.

54. Në këtë aspekt, duhet të nënvizohet se AKP-ja është themeluar përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/10 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën private të paluajtshme, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, të datës 4 mars 2006. Pak më vonë, Rregullorja nr. 2006/10 është shfuqizuar përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën private të paluajtshme, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, të datës 16 tetor 2006. Në nenin 22 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 thuhej se ajo Rregullore do të mbeste në fuqi deri më 31 dhjetor 2008, përveç nëse PSSP-ja ose "autoriteti kompetent trashëgues" do ta vazhdonte. Në ndërkohë, në bazë të Kushtetutës së Kosovës, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin nr. 03/L-079 të datës 13 qershor 2008 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale.

55. Përgjigja e UNMIK-ut në këtë situatë është dhënë në hollësi në raportin e Sekretarit të Përgjithshëm drejtuar Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara lidhur me Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (S/2009/149), të datës 17 mars 2009, paragrafi 24 i së cilit thotë:

"Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/50 lidhur me Agjencinë Kosovare të Pronës ka skaduar më 31 dhjetor 2008. Beogradi ka kërkuar nga Përfaqësuesi im Special atje për të shqyrtuar zgjatjen e mandatit të Agjencisë, dhe ai ka marrë pjesë në një numër diskutimesh me të gjitha palët relevante me interes, duke përfshirë autoritetet e Kosovës. Megjithatë, sinjalet që vijnë nga autoritetet e Kosovës, si dhe nga palët ndërkombëtare me interes, të përfshira në procesin e Agjencisë, deri më tani kanë qenë negative. Njëkohësisht, autoritetet e Kosovës dhe një drejtor ndërkombëtar, i emëruar nga Përfaqësuesi Ndërkombëtar Civil/Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian, kanë marrë kontroll të plotë administrativ ndaj Agjencisë, e cila tani është duke funksionuar në bazë të legjislacionit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës".

56. Rrjedhimisht, Paneli konsideron se periudha nën shqyrtimin e tij ka përfunduar më 31 dhjetor 2008, me rastin e skadimit të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50.

57. Nga kohëzgjatja e përgjithshme e procesit të zbatimit prej më shumë se dy vitesh a shtatë muajsh, nga Paneli mbeten për t'u shqyrtuar një vit, një muaj dhe pesëmbëdhjetë ditë.

58. Paneli vëren se para largimit të suksesshëm të datës 24 qershor 2009, largimet e tjera janë bërë më 28 shkurt 2007, 19 prill 2007 dhe 19 qershor 2007. Largimi i parë është kryer në shtëpinë e gabuar, ndërsa largimi i dytë dhe i tretë nuk kanë rezultuar me largimin e përhershëm të banuesit nga shtëpia e kërkuar në kërkesëpadi apo me hyrjen e ankuesit në shtëpi. Paneli është i vetëdijshëm për frustrimin e thellë, që këto tentime të dështuara mund t'ia kenë shkaktuar ankuesit, i cili ka qenë në pritje gjatë tërë kohës për të marrë në riposedim pronën e tij.

59. Megjithatë, Paneli nuk mund ta lë pa e thënë se deri në një shkallë të caktuar ankuesi ka kontribouar në vonesë, duke mos marrë çelësat e pronës. Në këtë aspekt, Paneli i referohet nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/60, ku parashihet se "cilido person, i cili pa ndonjë arsyetim të ligjshëm, hyn në pronë duke thyer plombën, mund t'i nënshtrohet largimit nga prona nga autoritetet e rendit dhe ligjit". Kjo dispozitë është interpretuar nga AKP-ja ashtu që ka qenë e obliguar të bëjë largimin shtesë vetëm nëse prona është uzurpuar përsëri brenda 72 orëve pas largimit (shih më lartë paragrafin 23). Kështu, ankuesi në fakt ka vendosur vetën në një pozitë të pazakontë që ka rezultuar me keqësimin e gjendjes së tij për shkak se nuk ka shkuar t'i merr çelësat. Po ti merrte çelësat pas largimit të parë apo të dytë që pretendohet të kenë qenë të suksesshme dhe po të kishte raportuar më pastaj se prona është uzurpuar përsëri, AKP-ja do të ishte obliguar të bëjë largimin tjetër. Në vend të kësaj, ankuesi refuzoi t'i merrte çelësat, duke bartur kështu obligimin e largimit tek policia. Mirëpo, pasi që prona asnjëherë nuk është konsideruar të jetë në posedim të ankuesit, policia ka deklaruar se ishte AKP-ja ajo që duhej të vepronte ndaj kërkesës për lirimin e pronës, pasi që policia nuk kishte juridiksion të vepronte për çështjet pronësore, përveç nëse prona është riuzurpuar (shih më lartë paragrafët 28 dhe 30). Kështu, ankuesi ka vënë vetën në situatë ku asnjëri prej organeve dukej se nuk është përgjegjës për zbatimin e largimit.

60. Për më tepër, Paneli konsideron se refuzimi i mëpastajmë i ankuesit për t'i respektuar procedurat standarde të punës të AKP-së, përderisa mund atij mund t'i është dukur i arsyeshëm në atë kohë, në fakt ka kontribouar në vonesën e përmbarimit të vendimit për lëndën e tij.

61. Pavarësisht nga vonesa në përmbarimin e vendimit të lëshuar nga HPCC-ja, Paneli konsideron, posaçërisht duke marrë parasysh sjelljen e ankuesit, që kjo vonesë nuk ka rezultuar, së paku jo deri më 31 dhjetor 2008, në refuzimin e së drejtës së ankuesit për përmbarimin e vendimit të formës së prerë dhe obligues.

62. Rrjedhimisht, nuk ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNj-së.

B. Shkelja e pretenduar e nenit 1 të Protokollit nr.1 të KEDNj-së dhe të nenit 8 të KEDNJ-së

63. Argumentet e ankuesit lidhur me shkeljen e pretenduar të së drejtës së tij për respektim të pronës së tij sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së dhe e drejta për respektim të familjes dhe jetës familjare dhe shtëpiake, në bazë të nenit 8 të KEDNJ-së, kanë të bëjnë me pamundësinë e vendosjes në shtëpinë e tij.

64. Paneli thekson se në ndërkohë situata është korrigjuar dhe se tani ankuesi është në posedim të plotë të pronës së tij. Si e tillë, nuk është më e saktë baza faktike lidhur me këto shkelje të pretenduara, në të cilën ankuesi bazohet. Për më tepër, Paneli vëren se baza e kërkesave të tij pronësore është bazuar në dështimin e pretenduar për të përmbaruar vendimin në dobi të tij. Në dritën e ndryshimeve të rrethanave faktike pas vendimit të Panelit për pranueshmëri, në përputhje me të gjeturat e Panelit, të cekura në

lartë në paragrafët §§ 49-62, Paneli konsideron se gjendja e vazhdueshme e ankuesit si viktimë, sipas nenit 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 është e diskutueshme.

65. Në çdo rast, Paneli thekson se shkeljet e pretenduara të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së dhe të nenit 8 të KEDNJ-së mbështeten në argumentet e ankuesit lidhur me shkeljen e pretenduar të nenit 6 § 1 të KEDNj-së. Pasi që nuk gjeti shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ-së, Paneli konstaton se nuk ka pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së apo të nenit 8 të KEDNj-së për shkak të arsyeve të cekura më lartë (shih PKDNj, *Vuçkoviq*, nr. 03/07, Mendimi i datës 13 mars 2010, § 60; PKDNj, *Angjellkoviq*, nr.11/07, Mendimi i datës 17 dhjetor 2010, § 108).

C. Shkelja e pretenduar e nenit 13 të KEDNj-së

66. Ankuesi thotë se "pasiviteti i skajshëm i autoriteteve në zbatimin e vendimit të formës së të HPCC-së tregon se mjeti ligjor i kërkuar para HPCC-së nuk ishte mjet i efektshëm ligjor".

67. Paneli përkujton se dispozitat e nenit 6 § 1 janë më të rrepta sesa ato të nenit 13 të KEDNj-së. Pasi ka konstatuar se nuk ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNj-së (shih më lartë, §§ 49-62), dhe duke vënë re se nuk ka ankesa të ndara lidhur me nenin 13 të KEDNj-së, Paneli duhet të shpallë se nuk ka pasur shkelje të nenit 13 të KEDNj-së (shih PKDNj, Vuçkoviq, nr.03/07, Mendimi i datës 13 mars 2010, § 60).

PËR KËTO ARSYE,

Paneli, njëzëri,

1. **KONSTATON SE NUK PASUR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTA TË NJERIUT;**

2. **KONSTATON SE NUK PASUR SHKELJE TË NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR. 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTA TË NJERIUT;**

3. **KONSTATON SE NUK PASUR SHKELJE TË NENIT 8 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTA TË NJERIUT;**

4. **KONSTATON SE NUK PASUR SHKELJE TË NENIT 13 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTA TË NJERIUT**

Anila PREMTI
Ushtruese e detyrës së zyrtares ekzekutive

Paul LEMMENS
Kryesues